



NJOFTIM PËR EKSPERTIZË TË JASHTME

“Inxhinjer Mekanik / Fushen e Transportit”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj. Nevojat e KOKSH janë pe 2 (dy) specialiste.

Në kuadër të Projektit “**Ekipet Sportive ne Shkolla**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kondidatët e interesuar për të aplikuar për ekspertize ne pozicionin “**Inxhinier Mekanik Ne fushen e Transportit**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme

Detyrat e Inxhinier Mekanik / Fushen e Transportit

Kërkohet një Inxhinier/e Mekanik i aftë për të hartuar terma reference teknike për automjet levizez. Inxhinjeri do të përfshihet në komisione në procesin e hartimit të termave të referencës, përcaktimin e specifikimeve teknike të nevojshme për mjetet e projektit “Ekipet Sportive ne Shkolla” dhe ne Komisionin e Vleresimit te Ofertave.



Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë përfunduar fakultetin e Inxhinjerise Mekanike
- Të paktën 3 vite eksperiencë profesionale në fushën e hartimit e specifkimeve teknike per mjetet levizese.
- Preferohet të ketë eksperiencë të mëparshme në hartimin e termave të references; Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze.

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira koordineuse, organizative dhe komunikuese;
- Të ketë aftësi shumë të mira në shkrimin e specifkimeve teknike në përgjithësi;
- Të zotrojnë në nivel shumë të mire "Paketën Office";
- Aftësi bashkëpunuese në grup.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 25 Mars

2024, ora 12.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al ose fizikisht prane zyrave te KOKSH